



26.04.2016

Ceremonia e Themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

I nderuar Kryeparlamentar Veseli,
I nderuari Kryeministër Mustafa,
I nderuar Ambasador Delawie (Delau),
E nderuar Ambasadore Viets (Vits) ,
I nderuar z. Hops (Hops),

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe të institucioneve ndërkombëtare,

Mysafirë të nderuar,

Kam kënaqësinë e veçantë t'i drejtohem këtij auditoriumi të nderuar me këtë fjalë rasti sot kur sektorit financiar në Kosovë po i shtohet një institucion me rëndësi të veçantë zhvillimore, i themeluar si rezultat i angazhimit të **institucioneve të Kosovës, të donatoreve dhe të sektorit privat. Mbështetja e palëkundur e donatoreve, në këtë rast USAID, KFW, SIDA** dhe të tjerë, ka qenë faktor kyç për të dizajnuar Fondin Kosovar për Garanci Kreditore në strukturën që i përshtatet nivelit zhvillimor të sektorit financiar dhe ekonomik në Kosovë. Themelimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore është inovacion në sektorin financiar të Kosovës, i cili shënon etape të re të zhvillimit në lehtësimin e qasjes në financim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë forca motorike e rritjes ekonomike, e krijimit të vendeve të reja të punës dhe si të

tilla, me një qasje optimale në financa, edhe faktor kyç i zhvillimit ekonomik të një vendi.

Sot në bote ka **mbi 2000 skema të Garancive Kreditore** që operojnë në ekonominë e zhvilluara si dhe në ato që janë në zhvillim e sipër. Kosovës i ka munguar një skemë e tillë dhe ky është momenti i përshtatshëm për ta themeluar atë, duke fuqizuar në këtë mënyrë sektorin financiar dhe atë privat. Ka qenë një privilegj për Bankën Qendrore që brenda mandatit të saj ligjor të kontribuojë në procesin e themelimit të Fondit, në veçanti në fushën e kornizës ligjore adekuate.

Studimet e bëra deri më tani tregojnë se, midis tjerash, qasja në financim është njëri nga problemet kritike që pamundëson zhvillimin e sektorit privat. Tashmë janë të njohura sfidat me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për qasje në financim në njërën anë, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet financiare gjatë vlerësimit të rrezikut për financimin e këtyre ndërmarrjeve në anën tjetër. Prandaj, nëpërmjet ofrimit të garancive kreditore, **Fondi do të shërbejë si katalizator i fuqishëm** në balancimin e këtyre sfidave duke përmirësuar qasjen në financim për bizneset. Në këtë mënyrë institucionet financiare do të mund të kanalizojnë likuiditetin e tyre në llojin dhe në vlerën e financimit të duhur për nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mekanizmat adekuatë të financimit do t'i ndihmojnë ato të zhvillohen, të krijojnë vende të reja pune, të eksportojnë dhe në këtë mënyrë ta pozicionojmë Kosovën në nivel konkurrues në tregjet regjionale dhe evropiane. Në momentin kur ta kemi arritur këtë nivel, atëherë Kosova do të ketë arritur të prezantojë ekonominë e saj në një cikël të rritjes së produktivitetit dhe të rritjes së përshpejtuar ekonomike. Është inkurajues raporti i fundit ekonomik i Bankës Botërore që vlerëson rritjen ekonomike për vitin 2015, **në nivelin 3.6 përqind i nxitur nga investimet**, për

dallim nga vitet paraprake që kryesisht ka qenë konsumi faktori që ka ndikuar në rritje.

Parakusht qenësor për funksionimin e mirëfillte të Fondit është që të ndërveprojë me një sistem bankar të qëndrueshëm dhe efikas. Rritja e vazhdueshme e konkurrencës në sistemin bankar, si dhe avancimi i këtij sektori, ka ndikuar që kostoja dhe kushtet e financimit bankar gjithashtu të shënojnë rënie, respektivisht përmirësim. **Norma mesatare e interesit në kredi në dhjetor 2015 ishte 7.7 përqind**, krahasuar me normën prej 9.3 përqind në dhjetor 2014. Ky nivel i normave të interesit tani më e ka bërë koston e financimit bankar në Kosovë të jetë në nivel të përafërt me koston e financimit në vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu, kreditimi i sektorit bankar ka shënuar rritje të dukshme, duke ngritur nivelin e **kreditimit në mbi 2 miliardë euro, me normë vjetore të rritjes prej 7.3 përqind** në dhjetor 2015, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kreditë kishin shënuar një normë vjetore të rritjes prej vetëm 4.2 përqind.

Kategoria që i kontribuoi më së shumti rritjes së kredive në përgjithësi ishte kategoria e **kredive për ndërmarrjet për qëllime investive**. Në kuadër të gjithsej kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet gjatë kësaj periudhe, kreditë investive kishin një pjesëmarrje prej 63.5 përqind.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të qëndrueshmërisë së sektorit bankar, rritjen e vazhdueshme të pozicionit të likuiditetit dhe të kapitalizimit dukshëm mbi nivelin e kërkuar nga Banka Qendrore, hyrja dhe pjesëmarrja aktive e Fondit në këtë sektor do të ndikojë fuqishëm që parametrat e lartpërmendur të kreditimit të vazhdojnë të shënojnë rritje dhe përmirësim të konsiderueshëm.

Gjendja e kënaqshme e stabilitetit të sektorit bankar pasqyrohet edhe nga cilësia e mirë e portofolit kreditor. Niveli edhe ashtu i ulët i **kredive joperformuese shënoi rënie të mëtejme**, duke rënë në 6.2 përqind në dhjetor 2015 nga 8.3 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Kjo normë e kredive joperformuese paraqet nivelin më të ulët të regjistruar që nga prilli i vitit 2012 dhe vazhdon ta mbajë Kosovën si vendin me normën më të ulët të kredive joperformuese në rajon.

Tani më lejoni të ndaj me ju disa nga faktorët që janë shume të rëndësishme për funksionim adekuat të Fondit me qëllim të arritjes së objektivave të themelimit. Brenda kornizës së organizmit ekzistues është thelbësore që Fondi të ketë **kapital të mjaftueshëm** në dispozicion për të siguruar fillimin efikas të aktiviteteve. **Kualiteti i mirë i kredive** të garantuara nga Fondi, **tarifa adekuate të operimit, mekanizma efektiv të menaxhimit të rrezikut, pavarësia operacionale dhe qëndrueshmëria financiare** janë esenciale për funksionimin dhe zhvillimin e Fondit. Këto mund të sigurohen vetëm me një **qeverisje korporative** të mirëfilltë dhe të integruar në kornizën institucionale të Fondit. Bordi i Drejtoreve dhe Menaxhmenti duhet të sigurojnë që një kornizë e tillë të jetë prudente dhe të funksionojë në përputhje me ligjin dhe me standardet më të mira të pranuar ndërkombëtarisht.

BQK-ja të do vazhdojë të sigurojë stabilitetin financiar që tani e gëzon. Roli i bankave në veçanti, por edhe i institucioneve të tjera financiare në përgjithësi, është shumë i rëndësishëm dhe ka ende hapësirë që ky rol të avancojë edhe më tutje në mënyrë që ndikimi i tij për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe për zhvillimin e mëtejme të vetë sistemit bankar të jetë edhe më i madh. Mbi të gjitha, së bashku kemi obligim kolektiv të kontribuojmë në ndërtimin dhe në zhvillimin e një Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë të pavarur, të qëndrueshëm

financiarisht, ne menyre qe ai të jetë në funksion të zhvillimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla. Për fund dëshiroj ta përbyll fjalimin tim me vlerësim të lartë për punën e shkëlqyer që është bërë deri më tani në themelimin e Fondit dhe me shpresën për angazhimin maksimal ndërinstytucional për ta shndërruar Fondin në katalizator të fuqishëm të ndërmjetësimit financiar në Kosovë.

Ju faleminderit!